

Enkelejda Shpuza ka lindur më 15 shkurt 1972. Aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Standardizimit të Shërbimeve të Gjendjes Civile, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Më herët ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Dokumenteve Biometrike dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Znj. Shpuza, në këtë rol, ka qenë përgjegjëse për menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore në shërbimin e gjendjes civile, si dhe për organizimin dhe monitorimin e punës në zyrat e gjendjes civile. Gjithashtu, ka menaxhuar procesin e personalizimit të dokumenteve biometrike dhe prodhimit të certifikatave, si dhe ka menaxhuar aplikimet për dokumente biometrike për shtetasit shqiptarë dhe të huaj me leje qëndrimi apo status azilkërkuesi.

Më herët, gjatë periudhës nëntor 2022–shtator 2023, ka ushtruar detyrën e specialistes në Sektorin e Hartimit të Procedurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku ka kontribuar në evidentimin e problematikave të shërbimit dhe hartimin e kuadrit rregullator kombëtar në përputhje me Planin Kombëtar të Integritimit.

Znj. Shpuza ka një eksperiencë të gjatë në administratën publike, kryesisht në Ministrinë e Brendshme dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku ka mbajtur disa pozicione si specialiste dhe përgjegjëse sektori në fusha të ndryshme, përfshirë sektorin e adresave. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka qenë e angazhuar në hartimin e procedurave dhe akteve ligjore e nënligjore, monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe në ndjekjen e kontratës koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike.

Para angazhimit në administratën publike, ka punuar në sektorin privat si administratore databaze pranë “British American Tobacco”, si dhe si koordinatorë projekti dhe përkthyes në një mision ndërkombëtar, ku ka kontribuar në përkthimin e bazës ligjore dhe trajnimin e efektivëve të Policisë së Shtetit. Karrierën e saj profesionale e ka nisur si mësuese e gjuhës angleze.

Znj. Shpuza ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Tiranës, ku fillimisht është diplomuar për Gjuhë Angleze (1995), ndërsa më pas ka ndjekur studimet në Fakultetin e Drejtësisë, duke përfunduar programin Bachelor (2014) dhe Master Profesional në të drejtën civile (2016).

Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze (niveli C2) dhe njohuri të mira të gjuhës italiane (niveli B2). Zotëron aftësi të mira organizative dhe drejtuese, është e aftë të punojë nën presion dhe në grup, si dhe ka njohuri të avancuara në përdorimin e programeve kompjuterike. Gjithashtu, mban titujt “Ndërmjetëse e Licensuar” dhe “Avokate”.